



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.109/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3500 (*tremijë e pesëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 29.09.2017, rreth orës 19:30, në fshatin “Bregu i Zi”, pra në shkollën fillore “Nezë Bujani” subjekti politik LDK kishte organizuar një tubim publik me qytetarë të fshatit. Më tutje ka shtuar se, me rastin e tubimit publik në murret e klasës – ambient shkollor, ka vendosur posterin e kandidatit Imri Ahmeti për kryetar komunës së Lipjanit nga radhët e subjektit politik LDK. Mirëpo aktivistët nga radhët e subjektit politik LVV kanë vërejtur që posterat e kandidatit në fjalë nuk janë larguar pas përfundimit të tubimit publik.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore nr.11/2013, dhe neni 3.4 Rregullës Zgjedhore nr. 13/2014 të KQZ-së.

Nga pretendimet e cekura ankimore, PZAP-it i ka kërkuar që subjektit politik LDK ti shqiptohen masa e sanksionit në mbështetje të nenit 3.3.2 sipas rregullave dhe procedurave të PZAP-it (Nr.01/2012).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy (2) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të datës 03.10.2017, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke e njoftuar PZAP-in se pas mbajtjes së tubimit janë harruar të largohen posterat e vendosur në klasë, pra në vendin ku është mbajtur tubimi publik. Më tutje ka shtuar se, aktivistët tonë nga radhët e subjektit politik LDK nuk kanë qenë të vëmendshëm për largimin e posterit, prandaj ka theksuar se, këto veprime nuk përbëjnë shkelje konkrete të dispozitës së nenit 33 të LZP-së dhe Rregullave zgjedhore të KQZ-së. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e

tyre i kanë bashkëngjitur një fotografi nga vendi i pa lejuar ku janë larguar posterat e vendosur.

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoi se :

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për kryetar për Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti nga radhët e subjektit politik LDK, është i vendosur në murret e klaseses, pra brenda ambientit të shkollës , veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli vërteton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkëlur neni 33, pika b), e LZP-së, pasi që posterit i kandidatit për kryetar të Kuvendit në Lipjan, nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur në vende publike përkatësisht në institucione arsimore. Paneli ka vlerësuar se shkelja zgjedhore e këtij lloji, duke përdorur institucionet arsimore jashtë kohëzgjatjes së tubimit publik është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në procesin e rregullt mësimorë dhe e njëjta shkelje është thyerje e parimeve themelore sipas nenit 2 të LZP-së. Pra të njëjtën shkelje subjekti politik LDK e ka pranuar, në përgjigjen në ankesë të datës 03.10.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, morri parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posterit i kandidatit të këtij subjekti politik është vendosur brenda institucionit arsimor. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e morri edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr. 109/2017 më datën 03.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.